



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 487 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 57, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e konservimit të furrës Nr. 104, të zbuluar gjatë kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit, në sheshin e zhvillimit të projektit "*Godinë banimi me 5 Kate dhe 1 kat nëntokë " në lagjen Nr.1, rruga " Mbretëresha Teuta", në zonë arkeologjike "B"*, subjekti "REI" sh.p.k., paraqitur nga restaurator Z. Valter Shtylla,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Konceptin e konservimit të furrës Nr. 104, të zbuluar gjatë kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit, në sheshin e zhvillimit të projektit "*Godinë banimi me 5 Kate dhe 1 kat nëntokë " në lagjen Nr.1, rruga " Mbretëresha Teuta", në zonë arkeologjike "B"*, subjekti "REI" sh.p.k., paraqitur nga restaurator Z. Valter Shtylla.
2. Subjekti "REI" sh.p.k duhet të kontrakttojë subjekt të licencuar, i cili do të kryejë konservimin dhe restaurimin e furrës Nr. 104 dhe pjesëve të elementëve të mbetur të furrave Nr. 103 dhe Nr. 106, sipas konceptit të sipërpërmendur, duke respektuar kondicionet:
  - lartësia e mbulesës të jetë mbi 2,5 m duke krijuar mundësinë për vizitueshmërinë e furrës së restauruar, nëpërmjet shkallëve, deri në nivelin e bazamentit të saj.
  - të ekspozohen pranë furrës Nr. 104, elementët e restauruar furrave të tjera, të sipërpërmendura, me qëllim bërjen e tyre të vizitueshme.

3. Zbatimi i punime të konservimit dhe restaurimit do të realizohet nën monitorimin ditor të DRKK Durrës, në bashkëpunim me ASHA.
4. ASHA të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar zyrtarisht pranë saj nga DRKK Durrës, e cila do të kryejë monitorimin ditor të punimeve të konservimit dhe restaurimit.
5. Subjekti "REI" sh.p.k. të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYLTAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**